



13,5 MG LEVONORGESTREL

Informacion për pacientin

Kjo është Jaydess®

Shpresojmë që kjo broshurë do t'u përgjigjet pyetjeve dhe shqetësimeve tuaja rreth Jaydess®.



Çfarë është Jaydess®?

Jaydess® është një pajisje intrauterine që përbëhet nga një kapsulë hormonesh e lidhur me një strukturë në formë T-je e bërë nga një material plastik i butë elastike. Pajisja është 30 mm e gjatë dhe futet brenda mitrës duke përdorur një pajisje vendosëse.


Jaydess® është unaza më e vogël 3-vjeçare hormonale e disponueshme dhe përmban një dozë të vogël hormonesh (sekrete 6 µg levonorgestrel / ditë). Mënia/mjeku juaj e fut atë në mitrën tuaj, ku ajo mbron kundër shtatzënisë të padëshiruar. Duke lëshuar ngadalë një dozë të vogël të hormonit progjestogjen, levonorgestrel lokalisht në mitër, çdo ditë deri në 3 vjet, nuk do t'ju duhet të mendoni për marrjen e kontraktivëve çdo ditë, javë ose muaj.

Si funksionon Jaydess®?

Kur Jaydess® futet në mitër, një dozë e vogël e hormonit levonorgestrel lëshohet ngadalë dhe vazhdimisht në mitër çdo ditë, duke parandaluar shtatzëninë në tre mënyra.

1. Jaydess e bën mukozën e qafës të mitrës të trashë, kështu që pengohet kalimi i spermës.
2. Jaydess ndikon në rritjen endometriale. Membrana mukoze bëhet e hollë dhe jopjellore.
3. Vetë pajisja kontribuon për një mjedis të papërshtatshëm për spermën në mitër dhe në tubat e fallopit. Ndikohet lëvizshmëria e spermës dhe parandalohet fertilizimi.

Jaydess® parandalon shtatzëninë me anë të një kombinimi të disa vetive të ndryshme.



Hormoni i vetëm në Jaydess® është levonorgestrel, një progjestogjen sintetik i cili është i zakonshëm në kontrceptivë të tjerë hormonalë. Jaydess® nuk përmban estrogen.

Sa i efektshëm është Jaydess®?

Jaydess® është një nga kontrceptivët më efikasë. Jaydess® është më shumë se 99% efikas kundër shtatzënisë nga koha që futet në mitër derisa hiqet. Jaydess® përdoret deri në 3 vjet.

Si do të ndikojë levonorgestrel, hormoni i Jaydess® në trupin tim?

Jaydess® punon kryesisht vetëm në mitër. Lëshon levonorgestrel në mitër dhe vetëm sasi të vogla të hormonit hyjnë në qarkullimin e gjakut. Levonorgestrel është një hormon i përdorur gjerësisht në kontrceptivë. Jaydess® nuk ndikon tek ovulacioni në shumicën e femrave. Kjo do të thotë që vezoret vazhdojnë të prodhojnë estrogenin e tyre. Për më shumë informacion mbi efektet anësore kur përdorni Jaydess®, [shiko më poshtë në këtë broshurë](#) dhe në fletëpalosjen që vjen bashkë me paketimin.

Cili është qëllimi i fijeve në Jaydess®?

Fijet në Jaydess® janë aty në mënyrë që mamia/mjeku ta nxjerrë jashtë. Mamia/mjeku do t'ju tregojë si t'i ndieni fijet pasi të jetë futur pajisja. Duke ndierë fijet ju mund ta vërtetoni vetë që Jaydess® është akoma në pozicionin e duhur në mitër, duke siguruar mbrojtje efikase kontrceptive. Për pyetje të mëtejshme rreth fijeve, mos ngurroni të flisni me maminë/mjekun tuaj.

Ditët tuaja të para me Jaydess®

Informacione të rëndësishme që duhet të dini para se të vendosni Jaydess®

Si vendoset Jaydess®?

Pasi të keni vendosur për Jaydess®, ajo mund të futet gjatë vizitës tuaj të ardhshme me maminë/mjeku tuaj. Gjatë një ekzaminimi të legenit ata thjesht mund ta futin Jaydess® në mitrën tuaj me një pajisje vendosjeje fleksibël. Pasi Jaydess® të futet, fijet e heqjes do të priten në një gjatësi prej 2-3 cm.

Çfarë duhet të pres pas vendosjes?

Shumica e femrave kanë konstatuar që vendosja është relativisht e thjeshtë, por disa mund të provojnë pak dhimbje dhe marrje mendsh gjatë vendosjes. Nëse keni dhimbje të forta ose nëse dhimbja nuk largohet brenda pak javësh pas vendosjes, duhet të kontaktoni maminë/mjekun tuaj.

Sa shpejt do të më mbrojë Jaydess® kundër shtatzënisë?

Nëse vendosni Jaydess® brenda 7 ditësh nga dita e parë e ciklit tuaj menstrual, Jaydess® do të sigurojë mbrojtje të efektshme të menjëhershme kundër shtatzënisë për deri në 3 vjet. Nëse Jaydess® vendoset në ndonjë moment tjetër të ciklit tuaj menstrual, ju duhet ta mbronni gjithashtu veten duke përdorur prezervativë për 7 ditët e para. Këshillohet që pasi të keni vendosur Jaydess® të prisni 24 orë përpara se të kryeni marrëdhënie seksuale.

Me Jaydess® nuk ju duhet të mendoni për marrjen e kontraktivëve çdo ditë, javë ose muaj.

A duhet të bëj vizita me maminë/mjekun pasi të kem vendosur Jaydess®?

Mamia/mjeku juaj do të vendosë nëse duhet të bëni vizita pas vendosjes. Do të merrni gjithashtu informacione nëse do t'ju duhet të bëni vizita të tjera.

Muaji i parë me Jaydess®

Informacione të rëndësishme që duhet të dini para se të vendosni Jaydess®

A ka ndonjë arsye tjetër për të cilën duhet të kontaktoj maminë/mjekun tim?

Duhet të kontaktoni maminë/mjekun tuaj nëse ndodh ndonjë nga situatat e mëposhtme:

- Keni dhimbje të forta ose gjakderdhje të mëdha pas vendosjes ose nëse dhimbja ose gjakderdhja vazhdon për më shumë se 5 javë.
- Mendoni se jeni shtatzënë.
- Keni dhimbje të forta barku, ethe ose sekrecione jonormale.
- Ju ose partneri juaj ndieni dhimbje ose siklet gjatë marrëdhënies seksuale.
- Keni ndryshime në strukturat e gjakderdhjes menstruale (p.sh. nëse keni pak ose aspak cikël menstrual dhe papritur bëhet shumë i gjatë ose i papërmbajtur).
- Ju krijohen probleme të tjera mjekësore, si migrena/dhimbje koke shumë të forta, probleme të papritura të shikimit, të verdhët ose tension i lartë.

Gjëra të tjera që duhet të dini kur përdorni Jaydess®

Si do të ndikojë Jaydess® në strukturën e gjakderdhjes time menstruale? A do të kem ciklin menstrual çdo muaj?

Do të keni më pak gjakderdhje menstruale, qoftë në sasinë e gjakderdhjes dhe në numrin e ditëve që do t'ju dalë gjak çdo muaj. 3-6 muajt e parë pasi futet Jaydess®, ju mund të keni pika ose gjakderdhje të ulët. Disa femra mund të kenë gjakderdhje më të gjata ose më të rënda gjatë kësaj periudhe, por kjo nuk do të thotë që do t'ju dalë gjak çdo ditë. Mund të jetë e dobishme të shkruani mënyrën si ju del gjak, në mënyrë që të shikoni nëse po përmirësohet ditë pas dite (në fund të kësaj broshure përfshihet një ditar menstrual).

Flisni me maminë/mjekun nëse gjakderdhja menstruale vazhdon të jetë më e rëndë se normale ose nëse po ju del gjak papritur për më shumë ditë se më parë.

Në disa femra, menstruacioni zhduket plotësisht kur përdorin Jaydess®. Nëse nuk keni patur gjakderdhje menstruale në 6 javët e fundit dhe jeni e shqetësuar se keni ngelur shtatzënë, bëni një test shtatzënie. Nëse del negativ atëherë nuk ju duhen teste të tjera, përveç rasti nëse keni simptoma të tjera që mund të tregojnë shtatzëninë (për shembull, përzierje, lodhje ose ndjeshmëri gjiri). Nëse gjakderdhja juaj menstruale ndalon ndërsa përdorni Jaydess®, ajo duhet të rifillojë kur Jaydess® hiqet.

A do të ndikojë Jaydess® në jetën time seksuale?

Kur Jaydess® është në vend në mitër nuk ka të ngjarë që ju ose partneri juaj ta ndjeni gjatë marrëdhënies seksuale.

E ardhmja juaj me Jaydess®

A duhet ta kontrolloj strukturën e gjakderdhjes menstruale?

Meqenëse ka mundësi që të vini re një ndryshim në gjakderdhjen tuaj menstruale, mund të jetë e dobishme të kontrolloni gjakderdhjen/pikimet që të ndihmoni veten dhe maminë/mjekun për të vëzhguar eksperiencën tuaj me Jaydess®. Në fund të kësaj broshure do të gjeni një ditari menstrual.

Po nëse vendos të kem fëmijë?

Jaydess® mbron kundër shtatzënisë deri në 3 vjet, por gjithmonë mund t'i kërkonti maminë/mjekut që ta heqë. Mund të provoni të ngeleni shtatzënë menjëherë sapo të hiqet Jaydess®. Shumica e femrave në studime klinike që donin të ngelnin shtatzënë arritën të lindnin brenda 1 viti pasi u hoq Jaydess®, e cila është e njëjta përqindje si ajo për femrat që nuk përdorin kontracetim.

Nëse doni të ngeleni shtatzënë

Gjërat që duhet të merrni parasysh kur planifikoni shtatzëninë

Agjencia Kombëtare e Ushqimit (Livsmedelsverket) në Suedi rekomandon marrjen e 400 µg acidi folik çdo ditë duke filluar një muaj para mbetjes shtatzënë dhe të paktën gjatë 12 javëve të para të shtatzënisë. Kjo shërben për të parandaluar spina bifida te fëmija. Një sasi e mjaftueshme acidi folik mbetet i rëndësishëm gjatë shtatzënisë, sidomos për formimin e gjakut të nënës për zhvillimin e fetuesit (Livsmedelsverket 2019).

Pyetjet më të shpeshta

A mund ta përdor Jaydess® nëse nuk kam lindur?

Po, por nuk është zgjidhja e parë për gratë që nuk kanë lindur për shkak të mungesës së eksperiencës klinike.

A mund ta përdor Jaydess® midis lindjeve?

Po. Koha më e hershme kur Jaydess® mund të vendoset është 6 javë pas lindjes dhe pastaj siguron mbrojtje kundër shtatzënisë për deri në 3 vjet. Mund të provoni të ngeleni shtatzënë menjëherë pasi mamia/mjeku e heq Jaydess®.

A ofron Jaydess® mbrojtje kundër sëmundjeve seksualisht të transmetueshme?

Jo. Jaydess® përdoret për të mbrojtur kundër shtatzënisë të padëshiruar dhe nuk ofron mbrojtje kundër sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV dhe SIDA. Është e rëndësishme që të përdorni një prezervativ për t'u mbrojtur kundër SST-ve.

Çfarë do të ndodhë nëse marr një sëmundje seksualisht të transmetueshme?

Nëse mendoni se jeni infektuar me një sëmundje seksualisht të transmetueshme ndërsa përdorni Jaydess®, kontaktoni me maminë/mjekun. Duhet të shmangni marrëdhëniet seksuale derisa të keni kontaktuar me ofruesin e kujdesit shëndetësor.

Po nëse ngelem shtatzënë ndërsa përdor Jaydess®?

Rreziku i ngeljes shtatzënë ndërsa përdorni Jaydess® është shumë i vogël, por mund të ndodhë. Fakti që nuk keni gjakderdhje menstruale kur përdorni Jaydess® nuk do të thotë medoemos që jeni shtatzënë. Nëse nuk i keni ciklet menstruale siç pritet dhe keni simptoma të tjera që mund të tregojnë shtatzëni (për shembull përzierje, lodhje dhe ndjeshmëri gjiri) duhet të flisni menjëherë me maminë/mjekun. Nëse ngelni shtatzënë, ekziston 50% rrezik që shtatzënia është jashtë mitrës.

Shenjat dhe simptomat e mëposhtme mund të tregojnë shtatzëni jashtë mitrës:

- Cikli juaj menstrual ka përfunduar dhe papritur keni gjakderdhje dhe dhimbje stomaku të vazhdueshme.
- Keni dhimbje të forta ose të vazhdueshme poshtë barkut.
- Keni simptomat normale të shtatzënisë, por gjithashtu mund të keni rrjedhje gjaku dhe marrje mendsh.

Nëse hasni ndonjë nga të mësipërmet, duhet të flisni me maminë/mjekun menjëherë.

A mund ta heq Jaydess® para se të kenë kaluar 3 vjet nga koha kur është vendosur?

Po. Në çdo kohë mund t'i kërkonit maminë/mjekut që ta heqë Jaydess®.

A mund të përdor tampona kur kam Jaydess®?

Po, por bëni kujdes kur tërhiqni tamponin në mënyrë që të mos tërhiqni edhe fijet që janë lidhur me Jaydess®.

A mund të bjerë Jaydess®?

Jaydess® mund të dalë jashtë pjesërisht ose plotësisht, por është shumë e pazakontë. Nëse besoni se gjakderdhja është më e rëndë se normalisht, mund të jetë shenjë që Jaydess® ka dalë jashtë (pjesërisht ose plotësisht). Nëse Jaydess® del jashtë ju nuk jeni më të mbrojtur kundër shtatzënisë. Duhet të shmangni marrëdhëniet seksuale ose të përdorni prezervativë dhe të konsultoheni me maminë/mjekun.

A mund të shkaktojë shtim në peshë një IUD?

Studimet kanë treguar se nuk ka ndryshim të shtimit në peshë te femrat që përdorin IUD në krahasim me femrat që përdorin kontraktiv pa hormone (p.sh. unazë bakri).

Pse ka një unazë argjendi në Jaydess®?

Kjo i mundëson profesionistët e kujdesit shëndetësor që ta dallojnë Jaydess® nga unazat e tjera kur bëjnë një ultratingull. Unaza e argjendit është pa nikel, por duhet t'i tregoni maminë/mjekut nëse jeni alergjik ndaj argjendit.

Cilat janë efektet anësore të zakonshme të Jaydess®?

Njëlloj si me çdo mjekim, mund të hasni disa efekte anësore me Jaydess®. **Më poshtë** është një listë e efekteve anësore më të zakonshme që kanë raportuar femrat kur përdorin Jaydess®. Nëse keni pyetje të tjera, mund të lexoni më shumë në fletëpalosje ose t'i telefononi mamisë/mjekut.

Shumë të zakonshme (prekin më shumë se 1 në 10 përdorues)

Dhimbje koke, dhimbje barku dhe legeni, puçrra/lëkurë e yndyrshme, ndryshime në strukturën e gjakderdhjes, ciste në vezore, inflamacion i jashtëm i gjenitaleve ose vaginës.

Të zakonshme (prekin më shumë se 1 në 100 përdorues)

Luhatje humori/depresion, migrenë, përzjerje, infeksion gjenital, menstruacion me dhimbje, dhimbje/siklet në gji, nxjerrje e pajisjes, rënie flokësh, rrjedhje vaginale.

Jaydess® Ditari menstrual

Ju lutem përdoreni ditarin menstrual në **faqen** tjetër për të mbajtur shënim çdo gjakderdhje ose sekrecione që mund të ndodhin në muajt e ardhshëm. Mos harroni se çdo femër është unike dhe se struktura juaj e gjakderdhjes mund të ndryshojë.

Udhëzime:

- Shënoni me një pikë (•) kur keni sekrecione.
- Shënoni me një X kur keni menstruacione normale.
- Ngjyroseni të gjithë kutinë (■) kur gjakderdhja menstruale është e rëndë.
- Lëreni kutinë bosh kur nuk keni gjakderdhje.

Informojeni mjekun në çdo takim që ju po përdorni Jaydess®

Jaydess®, pajisje intrauterine, 13,5 mg levonorgestrel.

Indikacione: Kontraceptim. Efektet anësore: dhimbje koke, dhimbje barku/legeni, puçrra/lëkurë e yndyrshme, luhatje humori dhe ndryshime në strukturat e gjakderdhjes menstruale. Paralajmërime/kujdes: Jaydess® duhet përdorur me kujdes ose të hiqet pas konsultimit me specialistin, nëse ndodh ose shfaqet për herë të parë një nga situatat e mëposhtme: dhimbje koke shumë të forta, migrenë fokale me humbje asimetrike shikimi, të verdhët, tension i lartë, goditje ose krizë zemre. Femrat që po marrin në konsideratë të përdorin pajisjen Jaydess® duhet të informohen për shenjat dhe simptomat, dhe rrezikun e shtatzënisë ektopike. Disa gra që përdorin kontraceptivë hormonale kanë raportuar depresion ose ndryshime të humorit. Nëse keni ndryshime në humor, kontaktoni maminë ose mjekun tuaj. Për femrat që nuk kanë lindur, Jaydess® nuk është zgjedhja e parë kontrceptive meqenëse eksperiencia klinike është e kufizuar.

GO2BA03 kontrceptiv. Rx. F.

Për më shumë informacion, shikoni fletëpalosjen në paketim dhe www.fass.se
SPC 2019-07-01 ▼ Ky produkt mjekësor është subjekt monitorimi të mëtejshëm.



Bayer AB, Box 606, 169 26 Solna, tel 08-580 223 00

JAN	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
SHK	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28			
MAR	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
PRI	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
MAJ	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
QER	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
KOR	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
GUS	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
SHT	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
TET	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
NËN	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
DHJ	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31